



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0016437-1/25 dt. 25.03.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 38-të

Koha: 25.03.2025 ora 15:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi, Habib Hajdini dhe Anesa Collakoviq

Mungoi: **Jeton Rrahmani**

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi zv. Kryesuesesja e Komitetit e cila fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot është thirrur mbledhja e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raport i vizitave sistematike mjekësore për nxënësit e klasave të para

Rendi i ditës u miratua unanimisht

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Zv. Kryesuesja e Komitetit znj. Elidiana Budini Haziri lidhur me Raportin e vizitave sistematike mjekësore për nxënësit e klasave të para, fjalën ia kaloi Drejtorit të Shëndetësisë z. Fahri Shabani.

Fahri Shabani: Vizitat Sistematike Mjekësore të nxënësve kanë një rëndësi të veçantë sepse përcjellin në mënyrë të vazhdueshme gjendjen shëndetësore të nxënësve dhe të rinjve. Ato kryhen në një grupmoshë të caktuar dhe synimi i tyre është zbulimi i hershëm i sëmundjeve apo devijimeve në zhvillimin psikomotor dhe shëndetit oral. Zhvillimi fizik përcaktohet nëpërmjet ekzaminimeve sistematike, zbulohen faktorët negativë në shëndetin e fëmijës, zbulohen anomalitë kongjenitale dhe të fituara, si dhe merren masa në kohë për zgjidhjen e devijimeve të konstatuara, trajtimin dhe rehabilitimin. Te fëmijët që tashmë kanë një sëmundje të zbuluar, monitorohet zhvillimi dhe trajtimi i sëmundjes. Vëmendje e veçantë i kushtohet zbulimit të hershëm të sëmundjeve dhe çrregullimeve më të shpeshta që mund të kenë kaluar pa u vënë re deri në ekzaminim dhe për këtë arsye fëmijët i referohen ekzaminimeve të mëtejshme specialistike sipas nevojës. Fëmijët e moshës shkollare janë kategori e veçantë për shkak të rritjes dhe zhvillimit aktiv karakteristik për moshën, prandaj si kategori e veçantë që janë kërkojnë edhe kujdes të veçantë shëndetësor. Madje shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve është tregues i rëndësishëm i gjendjes shëndetësore të popullatës në përgjithësi. Për shkak të mosekzistimit të mjekëve nëpër shkolla përkatësisht mjekësisë shkollore e cila do të mundësonte përcjelljen e zhvillimit dhe rritjes së nxënësve dhe rrjedhimisht do të zbulonte në fazat e hershme patologjitë të cilat do të mund të prevenoheshin, organizimi i VSM të nxënësve paraqet një ndërmarrje të domosdoshme dhe të dobishme e cila deri diku e kompenson këtë vakum, deri në implementimin e plotë të konceptit të Mjekësisë Familjare kur do të funksionalizohet në plot kuptimin e fjalës edhe komponenta preventive e kujdesit shëndetësor së bashku me kujdesin e vazhdueshëm biografik. Funksionalizimi i komponentës preventive edhe ofruesit edhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore do t'i obligon për vizita dhe ekzaminime të rregullta mjekësore, shërbime këto të cilat do të zbulonin fillimin e devijimeve në fazat e hershme dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe korrektuese. Parandalimi i sëmundjeve ka kosto më të lirë për sistemin dhe shërbimet shëndetësore se sa mjekimi i tyre, prandaj edhe ky fakt e rrit rëndësinë dhe peshën e kontrollave sistematike. Kujdesi për shëndetin e fëmijëve dhe adoleshentëve, përkatësisht kujdesi për rritjen dhe zhvillimin psikofizik të tyre paraqet njërin prej prioriteteve kryesore të politikave shëndetësore të shumicës së vendeve Evropiane. Fëmijët kalojnë nëpër periudha të ndryshme zhvillimi ndërsa kalojnë nga foshnjat te të rriturit e rinj. Gjatë secilës prej këtyre fazave, ndodhin ndryshime të shumta në zhvillimin e organizmit. Periudha e moshës shkollore mund të jetë një kohë e fazës

jetësore të zhvillimit që përfshinë zhvillimin e fizikut, intelektit, gjuhës dhe zhvillimin socio-emocional. Pas shtëpisë, shkolla përfaqëson mjedisin e dytë më të rëndësishëm në jetën e një fëmije. Të gjithë fëmijët kanë të drejtën për një mjedis shkollor të sigurt, mbështetës dhe të shëndetshëm. Shkolla njihet prej kohësh si një mjedis i rëndësishëm në shëndetin publik sepse ka një mundësi unike për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin për shëndetin që në moshë të hershme. Po ashtu edhe në Kosovë, mbrojtja parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkolla fillore, të mesme dhe të larta në territorin e komunës parashihet edhe me Ligjin për shëndetësi të Republikës së Kosovës. Përcjellja e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve përmes kontrollave sistematike nëpër shkolla mundëson zbulimin e nxënësve me çrregullime apo defekte fizike dhe mendore të cilat e pamundësojnë zhvillimin e drejtë të tyre. Këto kontrolla rrjedhimisht kontribuojnë në dizajnimin e politikave shëndetësore të cilat orientohen kah zgjidhja e problemeve të zbuluara. Të dhënat e fituara nga këto vizita sistematike do të krijojnë një pasqyrë të përgjithshme për gjendjen shëndetësore të nxënësve, do të identifikojnë problemet më të shpeshta shëndetësore apo ngecjet në zhvillimin dhe përparimin fizik dhe psiqik të nxënësve si dhe do të krijojnë një bazë të të dhënave e cila do të lehtëson dhe do të mbështesë dizajnimin e politikave shëndetësore por edhe ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të nxënësve.

Anëtarët e Komitetit për Komunitete e falënderuan Drejtorin e Shëndetësisë për raportin e përgatitur.

Mbledhja përfundoj punimet në ora 16:00 min.

Mitrovicë
25.03.2025

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Zv. Kryesuesja Komitetit
për 
Elidiana Budinihaziri

